

BEKIM HARXHI

85H-93-32

H 27



Gurqdhëndesi  
i vogël

SH-93-32

SH-93-32

5

H27

BIBLIOTEKA E PIONIERIT

BEKIM HARXHI

# GURGDHËNDËSI I VOGËL

(Tregime dhe skica)

~~47888~~

BIBLIOTEKA E SHKOLLËS  
PIONIERIT

1068

SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»

## SI JA MORËN RADION PREFEKTTI

**I**talianët dhe tradhëtarët, që sundonin aso kohe në qytetin tonë, ndiqnin me vëmendje dhe me shumë rreptësi të gjitha lëvizjet e dyshimta të banorëve.

Sipas urdhërit të prefektit, njerëzit duhej të mbylleshin me kohë brënda mureve të shtëpisë, ndryshe, të priste burgu.

Megjithatë, komunistët punonin dhe vepronin me shumë fshehtësi. Netët e errëta, bodrumet e thella dhe çatitë e shtëpive ishin strehët e tyre.

Anëtarët e Komitetit Qarkor të Partisë mblihdeshin në një ahur, në thellësi të një lagjeje dhe, nëpërmjet së vetmes radio, dëgjonin herë pas here lajmet. Atë radio e kishin si një shok të shtrenjtë, që u jepte zëmër dhe forcë. Prej saj mësonin se Ushtria e Kuqe korrte fitore kundër ushtarëve grabitqarë gjermanë: prandaj dhe e mbanin me shumë kujdes dhe fshehtësi.



Pas një kontrolli të imtë, në të gjitha lagjet e qytetit, policët e kuesturës mundën që ta gjenin dhe ta merrnin me vete radion e Komitetit Qarkor të Partisë.

Një ditë, dy fëmijë, që e njihnin mirë atë radio dhe kishin dijeni për grabitjen e saj, e ndoqën Milon, shërbyesin e prefekturës, këmbakëmbës, kur e panë me të në duar.

Ishin Astriti dhe Qazimi. Tek dera e shtëpisë, ku Milua u ndal, ata panë gruan e prefektit dhe dëgjuan këtë bisedë:

- Urdhëroni, zonjë, këtë radio!
- Ç'është kjo?!... Po ne kemi dy radio në shtëpi!...
- Ma dha prefekti, zonjë!
- Për mua?!
- Po, për ju, urdhëroni!
- Po ku e gjeti burri im këtë radio?!
- Me sa dëgjova, ia dhuroi kuestori.
- Të dy fëmijët u siguruan dhe më mirë.
- Ooo! — dhe me këtë pasthirmë kënaqësie zonja e prefektit u çel e tëra dhe mori një pamje tjetër.

Astriti dhe Qazimi, që qëndronin pas një kthese, sikur prisnin njeri, mbasi dëgjuan bisedën gjer në fund, diçka i mërmëritën njeritjetrit dhe u larguan menjëherë.



Të nesërmen, aty nga mesi i ditës, kur prefekti nuk ndodhej në qytet, trokiti dera e shtëpisë së tij.

— Kush është? — u dëgjua një zë gruaje nga brënda.

— Hapeni! Na dërgoi prefekti...

Dera u hap dhe përpara Astritit dhe Qazimit u duk gruaja e prefektit, tërë hund' e buzë, ende me rroben e natës, me flokët e mbledhura prapa.

— Ç'kërkoni, fëmijë, pse i bini derës?! Ooo, na morët mëndjen, na morët!... Mos doni bukë?!... Nuk është han shtëpia e prefektit!

— Po prefekti na dërgoi, zonjë!...

— Prefekti?!... Po ai... sikur iku sot...

Astriti e mori veten menjëherë:

— Po, zonjë, para se të hipte në veturë, më gjeti tek sheshi i qytetit dhe më tha: «Shko në shtëpi dhe i thuaj gruas sime të të japë radion e re dhe shpjerja babait për ta ndrequr!...» Ja, qe dhe ky atje kur m'i tha këto fjalë!

— Po, po, ashtu i tha!


— Pse, i kujt je ti?!

— Jam djali i Janos, i teknikut të radiove.

— Si e ke emrin?

— Ëë, më quajnë Thanas, po më flasin Nase.

— Mirë, Nase, prisni pak!





Ndërsa zonja e prefektit ngjiti shkallët, fëmijët bashkë me frikën filluan të ndjejnë dhe gëzimin e trillimit të «Nases».

Po gruaja e prefektit u kthye duarbosh.

— Nuk e jap radion, jo! Ku ta di unë se ju tha prefekti! Prisni të pyes një herë në telefon!

Fëmijët u panë me frikë në sy. Vendosën një herë të iknin me vrap, por prapë e mbajtën veten.

— Allo, allo! Jam Beharja, gruaja e prefektit!... Ti Sadik je?... U kthye prefekti në qytet?... Ashtu?!...

Dy djemtë e dëgjuan këtë bisedë me telefon, e kuptuan se prefekti nuk qe kthyer ende, u shkrifëruan në fytyrë dhe e ndjenë veten më të sigurtë.

— Po mirë, ju tha burri im se ç'ka radioja jonë?

— Na tha, po! — u tregua i gatshëm Qazimi.

— E po atëhere, ç'i mungon radios sonë?

«Bobo, na piu e zezal!», tha me vete Astriti dhe e qortoi shokun me shikim. Por, për çudinë e tij, Qazimi dha përgjigje bindëse. Ai e njihte mirë atë radio. Sa herë e kishte hapur dhe mbyllur në shtëpinë e tetos. Dinte edhe të dhëna të tjera për të:

— Ajo është radio «Filips», radio e fortë, po nuk i punon mirë treguesi i stacioneve...

Astriti shqeu sytë, ndërsa gruaja e prefektit i miratonte me kokë fjalët e Qazimit. Tanimë, e



bindur, pa folur fare, shkoi në dhomë dhe mori radion:

— Kujdes, mos t'ju bjerë nga dora, se ju mori dreqi, ju mori! Mbajeni të dy!... I thoni Janos ta ndreqë sa më mirë, si për prefektin!

— Ta ndreqë që ç'ke me të!... Ne do ta shpiem drejt e tek vendi! Mos u bëni merak, zonjë...! Ditën e mirë!

\* \* \*

Nëpër muret e qytetit, atë mëngjez, pionierët kishin ngjitur plot fletushka. Njerëzit mblidheshin tok dhe lexonin: «Prefekti dhe kuestori janë kusarë! Ata grabitën radiot e qytetit! Po ne ja punuam gruas së prefektit: ja morëm një radio të grabitur!»

Dhe fjala mori dhenë. Ato ditë, i madh e i vogël, radion e grabitur kishin në gojë.

Komunistët e vendosën atë në një lagje tjetër dhe, po atë ditë, ata dëgjuan fjalën e Stalinit, fjalën e fitores. Me ta bashkë ndodheshin dy pionierët, Astriti dhe Qazimi, të cilët, në ato çaste fluturonin nga gëzimi dhe e ndjenin veten të rritur në mes të atij grupi komunistësh.

## TEK URA E VJETËR

**A**të mëngjez gushti Bashkimi ishte ngri-  
tur, ndofta, më herët se çdo ditë. Më  
erdhi në shtëpi dhe më tregoi planin e tij për një  
aksion tjetër kundër italianëve.

\* \* \*

Në mbrëmje, kur dielli perëndoi prapa malit  
të Gjërë, ne u drejtuam për tek Ura e Vjetër.  
Atje takuam edhe fëmijë të tjerë, të cilët, sa  
na panë, qysh larg filluan të thërrisnin:

— Erdhi Bashkimi! Erdhi Bashkimi!

— Eeee, Bashkim, kemi zënë një ngjalë të  
madhe!

— Vraponi, se ujët është i mrekullueshëm  
për t'u larë!... Një, dy, tri, hopaaa! — hidheshin së  
bashku në lumë dhe sipërfaqja mbushej me stër-  
kala e shkumë.



Kur u shkuam afër, kush e kush më parë, e rrethuan Bashkimin, «heroin» e tyre të kërcimeve të guximshme, që nga maja e urës.

Një nga ata të lagjes Gropë, që Bashkimi e kishte kundërshtar të fortë në kapjen e peshqve, i tregoi pestrovën, si për t'i shitur mend.

— E shikon ç'kam zënë?!

— Me se?!

— Me karrema.

Bashkimi nuk ia zgjati më. Hoqi nga trupi këmishën e verdhë, duke zbuluar një gjoks të vogël në ngjyrën e çokollatës, vende-vende me muskulaturë të zhvilluar, dhe u drejtua për tek vendi ku ai lahej gjithmonë, pak më larg nga Ura e Vjetër. Me të shkuam edhe ne.

Mua, që nuk dija të notoja, më thanë të ruaja teshat nën hijen e rrapit.

Bashkimi u hodh i pari në lumë:

— Sot është kohë e mirë për peshkim!...  
Hidhu pa frikë! — i tha ai Bardhit

Në këto e sipër, kur Bardhi ishte futur në lumë gjer në gju dhe freskonte trupin, Bashkimi u zhyt i tëri në ujë. Unë u ngrita në këmbë dhe thirra i trembur:

— Uuuu, Bashkimi!... Ndhimoje, Bardhi!...  
Ai po mbytet e ti po qesh!...

Pa mbaruar mirë fjalën, mbi sipërfaqen e ujit dolën disa filuska me ajër dhe pas tyre u duk



koka e Bashkimit. Kur e ktheu fytyrën nga unë, i pashë midis buzëve trupin e një peshku, që lëvizte bishtin dhe e përplaste mbi faqen e tij. U shtanga për një çast me këtë skenë të papritur dhe të panjohur, po dhe u gëzova për peshkun tonë të parë:

— Po me se e zure atë peshk?!

— Me duar!

— Nuk të besoj! Më thuaj të drejtën me se e zure!

— Po ti e pe që s'kisha gjë në duar!... Na, merre!...— dhe ma hodhi përpara këmbëve.

— Iii, s'e kap dot me dorë!... Shiko si hidhet përpjetë!... Ta hedh prapë në lumë?...

Ngrita sytë për të marrë përgjigje, por kësaj radhe, tok me Bashkimin ishte zhytur në lumë edhe Bardhi.

Në këtë kohë, fëmijët që laheshin tek Ura e Vjetër, i dëgjova të thërrisnin:

— Kaçiatori! Erdhi kaçiatori!

Ashtu siç ishin, ca në ujë e ca në rërë, me vrap u drejtuan për në «aerodromin» e vogël, ndanë lumit.

Kur roja italiane i ndaloi të kalonin gardhin me tel, ata, duke mos ua vënë veshin fjalëve dhe britmave të tij, u shpërndanë si rabeckat përmes mullarëve me bar, duke thirrur për aeroplanin kaçiator, që fluturonte aqë ulur, sa që i dalloje në bisht tri ngjyrat e flamurit italian.

—... Se do t'u qëndrojmë besnikë komunistëve  
gjer në vdekje!

—... Se do t'u qëndrojmë besnikë komunistëve  
gjer në vdekje! — përsërisnim ne njëzëri.

— Vdekje fashizmit! — tha Bashkimi.

— Liri e popullit! — thamë ne.

Kthym kokën për herë të fundit nga fusha:  
Flaka dhe tymi, që kishin marrë qiellin, kishin  
mbuluar krejt mullarët me bar.

Ne u ndamë në hyrje të qytetit...

## CAMUNXAT

**P**ërpara se të filloj tregimin tim, ndonjeri, sigurisht, dëshiron të dijë se ç'janë camunxat:

Sa dukej pranvera në kopshtijet tona, kur bajamet dhe kumbullat çelnin lulet, ne na shkente mendja tek camunxat. Merrnim me vete thika buke dhe me to prisnim filizat e njomë dhe të drejtë të lofatës.

Uleshim më ndonjë skutë dhe me tehun e thikës shënonim mbi lëkurën e filizit një rreth të thelluar; paskëtaj, lëkurën e lagur e goditnim lehtë me dorezën e thikës, duke shoqëruar ritmin e lëvizjes së dorës me këto fjalë në gjysëm melodie:

*Dil, camunxëzë e re,  
Sa të piqet, moj një ve;  
Veja u poq,  
Camunxa u hoq!...*



Lëkurën e padëmtuar, në formën e një cilindri të hollë, e shtypnim pak nga njera anë dhe e frynim; ajo lëshonte një zë shponjës, që dëgjohej gjer larg.

Në ditë të tilla pranvere në qytetin tonë camunxat formonin korin e tyre të madh me zëra të ndryshëm, një kor që nuk pushonte gjer në orët e vona të mbrëmjes.

\* \* \*

Pranvera e vitit 1944 erdhi e ndrojtur edhe në qytetin tonë, përmes erës së barutit, tymit dhe zjarrit të luftës. Çizmet e ushtarëve gjermanë e linin qytetin pa gjumë gjer në thellësi të lagjeve të tij, megjithatë qyteti jetonte dhe çdokush dëgjonte tik-takun e zëmrës së tij plot urrejtje dhe hakmarrje për armiqtë.

Edhe ne fëmijët, që ishim strukur me prindërit tanë në bodrumet e errëta dhe plot lagështi të shtëpive tona të vjetra, e nuhatëm pranverën. Në ato ditë frike, camunxat u dëgjuan përsëri, po me një ritëm të ri dhe të fshehët. Dhe kjo kishte arësyeën e vet:

Në ato bodrume të thella ne zhvillonim mbledhjet tona, nën hundën e gjermanëve. Atje ne i raportonim për aksionet dhe punën tonë në ndihmë të komunistëve një të riu me ballin e gjërë dhe flokët që i binin shpesh herë përmbi sy.

Në mbledhjet tona vinin pionierë nga të gjitha lagjet e qytetit. Duhej të kalonin rrugë dhe rru-gica, përrrenj dhe ura të vogla për të ardhur gjer atje, në vendin e mbledhjes. Korierët venin dhe vinin pa pushim, duke vënë në rrezik edhe jetën.

Camunxat u vunë në përdorim. Korierët filluan të merreshin vesh midis tyre pa lëvizur fare nga vendi. Camunxa e parë, majë kodrës, laj-mëronte:

*-Ti-ti, ta-ta; Ti-ti, ta-ta!*

Dëgjonte kodra e dytë dhe përgjigjej;


*-Ti-ti, ta-ta; Ti-ti, ta-ta!*

Sinjalet jepeshin të natyrshme dhe të pandër-prera, nga kodra në kodër, megjithëse ato për ata, që i njihnin mirë, fshihnin zërin e lajmërimit.

...Ditët kalonin dhe, natyrisht, camunxat edhe thaheshin, po ne i zëvendësonim ato me të tjera. Atë këngë të njohur, që shoqëronte ritmin e lë-vizjes së dorës, e dëgjonin njerëzit edhe në ato ditë të rënda për qytetin tonë. Atë e dëgjonin edhe gjermanët e tradhëtarët.:

*Dil, camunxëzë e re,  
Sa të piqet, moj, një ve!  
Veja u poq,  
Camunxa u hoq!...*





Dhe lëkura-camunxë hiqej nga druri i lofatës  
që të nesërmen të dëgjohej përsëri:

-Ti-ti, ta-ta-tiii! - që donte të thoshte: «Fi-  
lloni aksionin për të thyer të gjitha llambat  
elektrikel!...»

Dhe kodra e dytë përgjigjej:

*-Ti-ti, ta-ta-tiii!*

Dhe qyteti i tërë gjëmonte:

*Ti-ti, ta-ta-tiii!*

Dhe brënda disa minutave rrugët dhe rrugicat  
e lagjeve errësoheshin, që komunistët ilegalë të  
kalonin dhe të vepronin më lehtë.



## THEATRI «ÇARÇAFI»

**N**jë ditë vere, në një faqe muri, në rru-  
gën kryesore të lagjes sonë, ne ki-  
shim ngjitur këtë lajmërim:

«FËMIJË, NGA TEATRI YNË, QË MBAN  
EMRIN «ÇARÇAFI» SË SHPEJTI DO TË  
SHIKONI PJESËN «PARTIZANËT DHE  
GJERMANI». SHFAQJA DO TË JEPET NË  
OBORRIN E KUJTIMIT. PËR DATËN DHE  
ORËN DO T'JU LAJMËROJMË MË VONË».

Për ta çfaqur këtë pjesë, duheshin gjithë-  
gjithë shtatë vetë: Katër partizanë, dy pionierë  
dhe një gjerman.

Në fillim u ndanë rolet e partizanëve. Të  
gjithë u grindën për to. Vazhduam me fjalë nja  
dy orë të tëra, sa na doli nga shtëpia gjyshja e  
Kujtimit e me romuzet e veta na nxori jashtë  
nga oborri. Ky avaz vazhdoi edhe ditën tjetër,  
qysh në mëngjes. U takuam përsëri në «sallën» e  
teatrit tonë, në oborrin e Kujtimit:

— E, si thon!, do të më jepni mua një rol partizani, apo ta heqim lajmërimin fare?!

— Mua më përket roli i partizanit, se dhe babi im ka qënë i tillë dhe, siç më ka treguar, i ka grirë gjermanët me automatik.

— Mos, more! Po partizane ka qënë edhe gjyshja ime! Sa herë u ka dhënë ajo ujë dhe ushqime partizanëve!

— Atëherë, s'kemi si të veprojmë ndryshe: Hedhim shortin.

Sa mirë do të ishte sikur ky mendim të na kishte rënë ndërmënd qysh dje!

Hodhëm shortin. E hapa letrën time me gjak të ngrirë. Lexova: «Partizani I». U hodha për-pjetë nga gëzimi.

...Në orën tre të mbasdites e lamë të takohe-shim përsëri po në sallën tonë. Do të ndërtonim skenën. Për këtë, na duhej që të sillnim nga një çarçaf, (këndeje e ka marrë emrin teatri ynë), nga një furkë, spango dhe një pemë të vogël që të tregonte se ngjarja zhvillohej në pyll.

Pa shkuar ora tre, Kujtimi kishte dalë nga shtëpia dhe po na priste tek pragu i derës.

Kur ja, në thellësi të rrugës u duk dhe Ylli me Kostën, që mbante në krahë një degë të madhe plot me gjethe. Ja dhamë gazit.

— Po ku do ta vendosim gjithë këtë degë?!

— Shëëët, mos flisni!



— Qënka kumbull, më duket!...

— Ja dhe sharra në dorë!

— Mirë që nuk sollët një pemë të tërë?!

— Shëëët, se do ta humbasim dhe këtë! Do të dalë gjyshi e të na bërtasë... Na ndihmoni!

Sa u futëm në oborr, dëgjojmë një zë gruaje:

—... O i paudhë, o i paudhë! Kërkon të marrësh dhe çarçafin e krevatit! Nuk të mjafton ai që të dhashë!...

—... Jo, e dua,...e dua, gjyshe!... Kemi shfaqje!... E dua për skenë, ta varim në furkël!...

— U, edhe në furkël!... Që të më vijë çarçaf'i ri për ta hedhur poshtë! Na, merre këtë të vjetrin dhe hiqmu që këndëj!

Ne që ishim fshehur prapa derës dhe që kishte dëgjuar të gjithë bisedën, rrinim dhe prisnim Astritin. Sa shkeli prakun, iu hodhëm përsipër, si për ta trëmbur:

— Ooo! — dhe ja dhamë gazet. Qeshëm akoma më shumë kur i pamë çarçafin: Një çarçaf për bukuri.

Ishim mbledhur të gjithë, me përjashtim të Vasilit që do të luante rolin e gjermanit. Koha po kalonte dhe ai s'po dukej. Provat nuk mund t'i zhvillonim pa të. Dërguam Palin për ta thirrur. Ai u kthye i vetëm, me buzë të varura:

— Nuk vjen!...

— Pse?! — pyetëm të gjithë njëzëri.

— Nuk e pranon atë rol!

— Pse nuk i the të vinte këtu dhe të sqaroheshim!?

— Nuk do, është prekur shumë!

— Dhe mundimi na shkoi kot!...

— Dhe degën e preva kot!...

— Dhe për këta çarçafë i hangrëm gjithë ato të shara!

Megjithëse na vinte keq, e qeshura nuk na mbahej, sidomos kur kujtonim përpjekjet tona me gjyshet.

Gjersa të takoheshim me Vasilin, e hoqëm dhe lajmërimin.

\* \* \*

I shkuam në shtëpi. Na e hapi derën e ëma.

— Urdhëroni brënda! — na tha ajo si kurdoherë.

— Jo, kësaj radhe do të rrimë jashtë. Kemi punë me Vasilin, — i tha Ylli — Është brënda?


Vasili, që, siç dukej, e dëgjoi bisedën tonë me nënën, doli vetë në krye të shkallëve.

— Tashti po vij! Më prisni sa të mbath këpucët!

Nëna e Vasilit, për të mos qëndruar ashtu të heshtur, sa të vinte ai, na pyeti:

— Ditën e diel do të jepni pjesën teatrale, apo jo?... Do të vij edhe unë me burrin tim. Do të na siguroni biletat?...





- Të shikojmë!...
- Pse, ç'ka ndodhur?!
- Jo, asgjë!
- Si e ka titullin pjesa?
- «Partizanët dhe gjermani».
- Po rolin e gjermanit kush e luan?
- Mua më ra shorti ta luaj, po nuk më pëlqen... — u përgjegj Vasili, duke zbritur shkallët.
- Ne, tamam për këtë kemi ardhur këtu!...
- Për ta lutur Vasilin?... — na tha e ëma. — E kini gabim!... Vetëm mëndjemadhi mund të lutet!...
- Unë nuk jam mëndjemadh, mami!
- Atëherë, je kokëfortë!
- Ne na vinte keq për Vasilin që e ëma e vuri përpara me gjithë ato fjalë, prandaj, për ta zbutur qortimin e saj, ndërhyrim herë pas here:
- Vasil, merr rolin tim, të «pionierit», dhe shfaqjen mos na e ler përgjysëm!
- Ne kemi lajmëruar edhe lagjen!
- Edhe udhëheqësen!
- Edhe prindërit!
- Për kokë të babit, nuk më vjen keq, merre rolin tim!
- Na pengon kot: Ti s'je gjerman me të vërtetë!
- E pe atë aktorin e Teatrit popullor, që lozte rolin e spiunit?!...



Nëna, me durim, na dëgjoi ne gjer në fund. Vasili një dorë e kishte vënë në dorezën e derës, ndërsa me majën e këpucës i binte herë pas here pragut të derës.

— Shiko, Vasil, kanë ardhur për ty gjashtë shokë dhe po mundohen të të mbushin mendjen! Në radhë të parë duhet të kuptosh se ke mendim të gabuar!

— Po vetë babi më ka treguar se ushtarët gjermanë kanë qenë njerëz të këqij!

— Po, shumë të këqij, prandaj edhe ti luaje mirë rolin tënd, në mënyrë që ne t'i urrejmë ata!

— Po pse ta marr unë atë rol?!

— Po kush ta marrë!? Mos duhet të thërresim një gjerman?!... Këta, me siguri, mund ta zëvendësojnë rolin tënd, por, dije mirë se s'ke të drejtë më t'i quash «shokë»... Ju faleminderit, fëmijë! — na u drejtua neve — Ju mund të shkoni tani; Vasili le të veprojë si të dojë!...

Kaqë tha dhe u largua, ndërsa ne nuk hodhëm asnjë hap përpara. Nuk donim ta linim Vasilin në atë gjendje.

— E, si thua, do të fillojmë provat?!

— ...

— Do të tallen me ne, në rast se nuk e nxjerrim pjesën.

— Ku të futemi nga turpil!...

— Si thua, Vasil, do të vish?!... Merr rolin tim, po të duash!

Vasili, si dëgjoi këshillat e shokëve, u kredh në mendime dhe në fund tha:

— Do të vij, por...

— Çfarë?!

— Tjetër herë nuk dua më role të tilla!...

— Mirë! Për fjalë të nderit, në pjesën «Çeta e trimave» do të të japim rolin e partizanit.

Vasili e hoqi dorën nga doreza e derës, u shkëput nga ai vend ku qëndroi si i lidhur me minuta të tëra dhe u fut në mesin tonë.

Ne i vendosëm lajmërimet përsëri.





## RRETH ZJARRIT PARTIZAN

**N**ë kohën që po shkruaj për ju, unë jam i rritur, megjithatë, në këtë tregim, dëshiroj që, sado pak, t'ju ndihmoj juve, fëmijë.

... Më kujtohet si tani: Udhëheqësja e çetës më kishte dhënë vjershën «O ju zjarre partizane» për ta mësuar përmendësh dhe për ta recituar rreth zjarrit partizan, me rastin e një feste.

Prej kohësh, kishte filluar të më pëlqente vetja si recitonjës. Kisha dalë disa herë në skenën e shkollës dhe të qytetit. Nga lavdërimet e shokëve, ndonjëherë edhe të udhëheqëses, sikur kisha kapur qiellin me dorë, aqë sa, një ditë, kur mbarova provat e recitimit në shtëpi, i thashë gjyshes: «S'ka si unë!». Edhe përgjigjen e saj e mbaj mend: «Vetëm kalliri, që s'ka kokrra, e mban kokën lart, biro!». S'më erdhi mirë...

Që të mos zgjatemi, vjershën e përgatita brënda pak ditëve; për këtë udhëheqësja më

lavdëroi, pastaj më tregoi se rreth zjarrit partizan do të ndodheshin dhe mjaft të ftuar. Pashë edhe programin. Unë kisha nderin ta hapja atë me vjershën time.

... Erdhi dhe ajo mbasdite. Mua më lindën mendime të këqia: «Do të qëndroj në shtëpi, shokët le të vijnë e të më kërkojnë vetë. Me siguri, pa mua ata s'mund të fillojnë! Sa lezet ka kur dëgjohet çoku i derës së shtëpisë dhe «koriesët», që i ka dërguar udhëheqësja, të kërkojnë ty!... E ti, që nga shtrati, pa u ngritur fare, i lajmëron se do të vonohesh ca. Mendo si kanë për të të pritur që të gjithë kur të shkosh atje, o recitonjës! Ai që do të të pikasë i pari, do të lajmërojë të tjerët dhe, kur ti të shkosh afër tyre, do të të mbulojnë me duartrokitje. Ti, s'do mend, do të krekosesh si gjeldeti...»

Këto mendime, ndofta, dhe të tjera si këto, më shkonin ndërmend atë ditë, përpara se të ndizej zjarri partizan.

Vendosa të dilja jashtë shtëpisë, të më kërkonin nëpër qytet. Kësaj radhe dola nga deriça e kopshtit për t'u futur në rrugicën, që më nxori tamam atje, ku do të ndizej zjarri partizan.

Me kujdesin më të madh, pa më parë njeri, u ngjita në një mur, një pjesë e të cilit mbulohej nga degët plot gjethe të një peme. Atje u struka si ndonjë iriq dhe që andej shikoja të gjitha lëvizjet:





«Ja dhe udhëheqësja!... Duket shumë e shqetësuar... Me siguri që më kërkojnë!... Po motra ime ç'kërkon pranë udhëheqëses?!... Çfarë është duke i thënë ashtu si me lutje?!... Ja dhe Arbeni erdhi me një frymë!... I shkreti Arben që është lodhur kot së kërkuari!... Sa mirë kështu t'i vësh në lëvizje të gjithë!... Po motra ime, pse nuk i ndahet?!...».

Në shesh ra heshtja. Fjalën e mori udhëheqësja; u dëgjua zëri i saj i dredhur: «Programin tonë rreth zjarrit partizan e hap Tefta me poezinë «Partizani i vogël»...». Shtanga në vend. Përpak sa s'rashë nga muri... Ah, motër, motër!...

Tefta recitoi pa u penguar fare. Ata që ishin atje, me sa pashë dhe dëgjova, e pritën mirë. Duartrokitjet vazhduan gjatë. Ato më ranë mua si shkopinj mbi shpinë, mbi kokë, mbi të gjithë trupin. Ato s'kishin të pushuar si për inatin tim. M'u tha pështyma në grykë.

Mezi zbrita nga muri për të shkuar përsëri në shtëpi.

---



## «JU LUTEM, SA E KINI ORËN?»

**A**i rrinte gjithmonë atje në atë stol në mes të lulishtes. Ishte një plak i qetë dhe i dashur për të gjithë fëmijët që i shkonin afër; sidomos në të lagjes ishim miqësuar aqë shumë me të, saqë, kur nuk e takonim, e ndjenim mungesën e tij.

Plaku tregonte ngjarje të kohëve të ndryshme dhe ne rrinim e dëgjonim me vëmendje. I tregonte aqë bukur, sa na linte me gojë hapur. Kur ai mbaronte, ne i luteshim: «Gjysh, na trego edhe një tjetër!... Na trego edhe një!...». Dhe plaku nuk përtonte. Po kishte edhe raste të tjera që nuk na e plotësonte dëshirën. Sa i çuditshëm që dukej ai plak!

Njëherë, edhe mua më mbajti mëri. Atë mëngjez unë dola nga shtëpia, iu afrova plakut dhe e pyeta:

— Xhaxho, sa e ke orën, more?!

Por plaku, për çudi, nuk më ktheu përgjigje. Duke menduar se do t'ishte sëmure, shkova më afër dhe me zë më të fortë e përsërita pyetjen:

— O ti, xhaxho, sa e ke orën, more, orën?!

Por plaku përsëri nuk foli. Unë ja përsërita edhe herë të tjera pyetjen, po përgjigje prapë nuk mora. Mërmërita nëpër dhëmbë fjalë pa kuptim dhe u largova për në shtëpi. Çudi e madhe! Kjo ndodhte për herë të parë midis plakut dhe meje, apo, më mirë, midis meje dhe plakut.

Për qëndrimin dhe heshtjen e tij, unë fola me motrën më të madhe.

— S'është e mundur, — më tha ajo, — plaku flet me të gjithë! Ai i do njëlloj të gjithë fëmijët. Pse nuk tregon të drejtën, ç'ka ndodhur?!

— Të betohem, unë nuk e kam fyer! Unë i kërkova të më tregonte se sa ishte ora, po ai as që më dha përgjigje. Ja, kjo është e gjitha!

— Me që qenka kështu, eja me mua të shkojmë tek gjyshi! Atje do të provohet fjala jote.

Shkuam në lulishte dhe plakun e gjetëm tek vendi.

— Mirëdita, gjysh!

— Mirëdita, moj bijë!

U habita! Si është e mundur?!... Plaku pak më parë... U mata të flisja, po motra më ndërpreu me pyetjen tjetër:



— Ju lutem, sa e kini orën, gjysh?!

Plaku, pa përtesë, futi dorën në xhepin e jeketut dhe nxori që andej një orë të rrumbullakët dhe, si e hapi kapakun e saj, i dha përgjigje motrës.

Sa s'plasa nga marazi! Pa ta pyes edhe unë një herë:

— O ti, xhaxho, pse s'më tregon dhe mua sa është ora, more?!

Po ai prapë nuk foli, ndërsa motra vuri buzën në gaz. Atëhere unë u nxeha dhe iu drejtova motrës me këto fjalë:

— Po tani kush e ka fajin?! Plaku mua më ka inat!... Pse nuk flet, o plak?!... Folë!...

Po përgjigjen mua ma dha motra në shtëpi. Ajo më tregoi gabimin. Paskëtaj, unë u miqësova shumë me gjyshin. Pse?...

---

## KUJTESA

**D**je, gjithë mbasditen, kam qëndruar në shtëpi për të mësuar vjershën. Më kot, s'më hynte në kokë! Gjithë-gjithë katër strofa ishin, por ç't'i bësh kujtesës!... S'e kam fajin unë! Nuk mund të mbaj në kokë asnjë varg, pa le katër strofa. Dola në oborrin e shtëpisë; lexova e lexova me zë të lartë, por prapë më kot! U lodha duke mësuar, gjysëm ore pa pushuar fare! Më tepër nuk mund të qëndroja për një vjershë! Vendosa të veproja ndryshe: Pesë minuta të lozja dhe pesë të tjera të thoshja vjershën. Por prapë nuk më shkoi mbarë. U mërzita! S'kam ç't'i bëj kujtesës! Do të shkoj një herë tek mjeku të më japë ndonjë ilaç.

\* \* \*

Sot mësuesja më ngriti për të thënë vjershën. Rrugës, duke shkuar për në shkollë, e përsërita edhe një herë me vete.



Mësuesja, siç kuptova, priste t'ja thoshja mirë, qartë dhe pa gabime. Unë i vura duart nga prapa, nxora gjoksin përpara dhe kokën e mbajta drejt.

Strofën e parë e thashë shumë mirë. Kur i erdhi radha strofës së dytë, më mbeti pështyma në fyt. E fillova përsëri nga e para, me shpresë se mësuesja do të më ndihmonte, por nuk më eci. Shokët filluan të qeshnin; edhe unë atë prisja:

— Mësuese, nuk mund ta them vjershën!... Shokët po më hutojnë... E harrova fare!...— dhe ula kokën sikur po qaja.

Mësuesja e qetësoi klasën, ndërsa unë e fillova vjershën përsëri. Mendova të hidhesha një herë nga strofa e parë në të tretën, dhe ashtu veprova, por ç'e do, se dhe atë të shkretë nuk e mbaja mend. Si e pashë që nuk mund të shpëtoja, mora guximin dhe i thashë mësueses:

— Nuk mund ta them më! S'kam kujtesë! S'e kam fajin unë! Punova dje gjithë ditën dhe...

Mësuesja vuri buzën në gaz, më pyeti gjerë e gjatë se si mësoj, kë kam në shtëpi, (mësuesen e kemi të re dhe nuk na njeh mirë), më pyeti se në ç'vend mësoj, e më drejtoi edhe pyetje të tjera, që unë nuk i mbaj mend, sepse, siç ju thashë, s'kam kujtesë. Më në fund më uli në vend. Shoku i bangës më tha me zë të ulët: «E këpute një katër!...»

Në sallën më të madhe të shkollës, nga grupet tona do të jepej një koncert i madh artistik. Kisha shumë dëshirë të merrja edhe unë pjesë. Po me se?!... Të futesha në kor?! S'kam qënë në prova asnjëherë, pastaj edhe zërin nuk e kam të mirë. Të futesha në grupin e valleve?! Edhe këtu sikur s'ja shkrep... E gjeta: Do të recitoj ndonjë vjershë!

Shkova dhe i thashë udhëheqëses së çetës; ajo, mbasi mirëkuptoi dëshirën time, më dha një vjershë me gjashtë strofa.


— Ta mësosh shpejt, — më tha, — sepse duhet të dalësh dhe në prova!

Sa mbaruan orët e mësimet, shkova drejt e në shtëpi. Si hangra bukë, u futa në dhomën tjetër. Atje mësonte motra e vogël. E nxora jashtë; filloi nga ankimet, po ku priste puna...

— Shpejt, moj, se jam në hall të madh!

Ajo s'e bëri të gjatë, kur më pa ashtu të nxehur. E mbylla derën me çelës dhe gjithë vëmëndjen e përqëndrova tek vjersha. E lexova një herë të gjithë. Më pëlqeu shumë. Fillova të vija në vend këshillat e mësueses. (Ju nuk e dini: mësuesja, mbasi ra zilja, më thirri, më këshilloi dhe më dha udhëzime se si mund të mësohet një vjershë përmendësh).





... Pra, u mbylla në dhomë. Librin e lashë mbi tavolinë. Mbasi e lexova dy-tri herë të gjithë vjershën, u ndala në strofën e parë. Fillova ta thoshja pa e parë në libër. Kështu veprova edhe për strofat e tjera. Në fillim, kur mësova të fundit, harrova të parën, prandaj i përsërita që të gjitha bashkë. Më mbetiedhe gjysëm ore kohë. Duhej shpejtuar. Prova e fundit më doli mirë. Hipa mbi një karrige dhe me zë të fortë fillova të recitoja. Sa gëzim: Asnjë fjalë nuk harrova!

Nga prapa derës motra filloi të qeshte. E futa në dhomë të më dëgjonte. E ula mbi karrige dhe vetë hipa mbi krevat.

— Pas recitimit, ti më duartrokit! — i thashë unë asaj.

Kur mbarova, motra as që i përplasi duart.

— Vjershën e ke mësuar mirë, po bërtet shumë dhe pa vend! — më tha ajo.

Në fillim vërejtja e saj m'u duk e hidhur. Në provën e fundit ajo më duartrokiti me gjithë zemër.

\* \* \*

Në orën e caktuar u ndodha në shkollë. Në prova dola shumë mirë. Plot fjalë urimi dëgjova, por mua, në ato çaste, më shkante mendja në skenë, atje ku do të recitoja. Djersët më mbuluan ballin, megjithatë, kujtesa nuk më tradhëtoi.



## DHURATA

**D**isa ditë më parë më erdhën në shtëpi shoqet dhe shokët e klasës: Frosina, Bardha, Sandri dhe Miri. Që të katër janë nxënës shëmbëllorë në mësimet dhe në punët e ndryshme të organizatës sonë.

Atë mbasdite ne zgjidhëm ushtrimet e aritmetikës. Mos mendoni se punuam bashkë! Jo! Ne i zgjidhëm vetë, pa ndihmën e njeri-tjetrit. Ne kështu punojmë gjithmonë. Në rast se ndonjeri has vështirësi në punën e vet, kërkon ndihmën e tjetrit.

Edhe atë ditë na shkoi mbarë. Ju vetë e dini se sa të qetë dhe të kënaqur e ndjen veten kur ke përfundime të mira në punë.

Si mbaruam së mësuari, u ulëm të pestë afër dritares. Në dhomën tonë është ngrohët dhe ka qetësi. Frosinës i pëlqejnë shumë këngët partizane. Ajo i fillon e para dhe ne i shkojmë pas.

Kënduam e kënduam, si asnjëherë. Paskëtaj, Sandrit i ra ndërmend festa e Vitit të ri. Si të gjithë shoqet dhe shokët, edhe ne do ta festojmë në shkollë. Një kartolinë urimi do t'ja dërgojmë edhe Arbenit, shokut tonë, që sivjet vazhdon shkollën në një fshat të rrethit; ndërsa Bardha ishte e mendimit t'i përgatitnim një dhuratë shërbyeses së shkollës. Të gjithë e miratuam mendimin e saj. Po çfarë t'i dhuronim Tetos?! (Kështu e thërresim ne shërbyesën e shkollës). Kjo pyetje na vuri në mendime që të gjithëve.

— Një pako me portokalle!...

— E ç'i duhen Tetos portokallet?!... Më mirë një send që t'i mbetet kujtim përgjithmonë, për shembëll...

—... Një shami pionieri!...

Të gjithë u gajasëm së qeshuri.

— E ku ta dijë Tetua se Frosina kërkon ta pranojë në organizatën tonë!

... Ne e përgatitëm pakon, lajmëruam dhe udhëheqësen. Sipër pakos, në një letër të bardhë, lamë këtë shënim:

«Tetos sonë të dashur dhe të kujdesëshme, me rastin e Vitit të ri, duke i uruar shëndet dhe lumtëri!

Nxënësit e klasës...»

I shkuam në shtëpi. Ajo nuk ndodhej atje; edhe ne këtë donim. Dritaren e shtëpisë përdhese





e kishte lënë hapur. Në oborr u fut Miri, ndërsa ne qëndruam tek dera. Ngadalë, ai iu afrua dritares, Si u sigurua edhe një herë se nuk kishte njeri, me shkathësi e hodhi pakon brënda në dhomë.

\* \* \*

Mësuam se Tetua e kishte marrë dhuratën. Sa ishte gëzuar ajo! Udhëheqësja do t'ja kishte treguar të gjitha, sepse, sa u futëm në oborrin e shkollës, Tetua na përqafoi dhe na falenderoi, na uroi që të dalim sa më mirë me mësimë. Ajo na ftoi që t'i shkonim në shtëpi; edhe ne e ftuam atë.



## I VETËM NË RRETHIN E RROBAQEPSISË

**Q**ysh në fillim unë u regjistrova në rrethin e rrobaqepsisë. Më pëlqen ky zanat. Dashurinë për të ma'ka ushqyer edhe im atë, i cili punon si rrobaqepës në kooperativën e qytetit.

\* \* \*

Shtëpia e pionierit, atë mbasdite tetori, u mbush plot me pionierë. Sipas rretheve, të gjithë u futën brënda. Edhe ne të rrethit të rrobaqepsisë u futëm në një dhomë të rregulluar mirë, me plot dritë, me perde të gjata të ngushtuara në mes me fjongo; maqinat qepëse qëndronin në radhë; në krahun tjetër të tyre, pothuaj afër faqes së murit, qëndronin dy vitrina me xham, ku ishin vendosur punimet më të mira të rretheve të rrobaqepsisë, punuar nga pionierët e viteve të kaluara.

Të mos futemi në hollësira të tjera; ne gjithëgjithë atë ditë ishim rreth 20 pionierë, ose, më mirë, 'unë' isha i vetmi djalë në mes të vajzave.

Filluan pëshpëritjet dhe ngacmimet:

— Po ky ç'kërkon në rrethin e rrobaqepsisë?!

— Rrethi ynë nuk është për ju djemtë!...

— E pse nuk shkon në rrethin e zdrukthëtarëve të punojë ndonjë karrige?!

— Ne do të qepim fustane, po ky me se do të merret?!...

U hap dera e dhomës. Zgjati kokën një pionier bullafiq. Si pa mirë e mirë me ata sytë e tij të mëdhenj, filloi të më thumbonte me zërin e tij të hollë si të një vajze:

— Tungjatjeta, shoku përgjegjës i vajzave! Po cilat janë detyrat e tua, shoku përgjegjës?! Mos vallë të numëroni ato që do të qepin vajzat, apo...

Në dhomë hyri instruktorja; të qeshurat e vajzave u ndërpre në. Ajo, midis të tjerave, më përgëzoi dhe mua për dëshirën që pata për të ndjekur rrethin e rrobaqepsisë. Si me shaka më tha se do të më ndihmonte në mënyrë të veçantë për të mësuar shumë shpejt dhe për t'ua kaluar vajzave, të cilave, kur dëgjuan këto fjalë, nuk u erdhi mirë.



\* \* \*

Unë shkoja rregullisht në rreth. Dëgjoja me kujdes instruktoren, mbaja dhe shënime në një fletore të veçantë. Edhe me vajzat sikur fillova të mësohesha, apo, më mirë, u mësuan ato me mua, megjithëse ndonjëherë nuk harronin të më ngacmonin.

... Provat për të mësuar maqinën qepëse i kalova mirë dhe, mund të them pa mburrje, më mirë se disa vajza, që nga ngutja i thyenë edhe disa gjilpëra. Mos t'ju vijë çudi: Të punosh në maqinën qepëse, nuk është aqë e lehtë, sa mund ta mendoni!

Një pjesë të vajzave instruktorja i caktoi të punonin në maqinën time. U erdhi thartë. Filluan të pëshpërisnin:

— Uuu, pse me të do të punojmë ne?!

— Ne jemi vajza dhe të mësojmë nga djali!...

Unë nuk flisja fare; vazhdoja punën time si gjithnjë. Edhe vajzat, donin s'donin, filluan të më afroheshin dhe bashkërisht e mësuam mirë maqinën qepëse.

\* \* \*

Orët e rrethit në Shtëpinë e pionierit kalonin të qeta dhe të këndëshme. Ne punonim që të gjithë si një familje e vetme.

Një ditë, bullafiqi erdhi përsëri në dhomën tonë, por, sa hapi gojën për të më ngacmuar, iu derdhën vajzat e ta bënë leckë.

... Në dhomën tonë, tanimë, hynin e dilnin shumë vizitorë. Ata vinin për të parë punimet tona. Vajzat tregoheshin të gatshme për të më lavdëruar:

— Ja, këtë kostum pionieri e ka qepur Petriti!

— Edhe këtë kostum vallejel!... Ja, shikojeni!...

— E kemi rrobaqepësin më të mirë të rrethit! Një ditë na erdhi dhe fotografi. Vajzat filluan të ndrronin fjalë me njera-tjetrën, sepse secila kërkonte të rrinte afër meje. Mua dhe instruktoren na vunë në mes. Të gëzuar dhe të qeshur dolëm në fotografi.

Për rrethin tonë të rrobaqepësisë flitej edhe në rrethet e tjera të Shtëpisë së pionierit. Pionierët gjenin rastin për t'u futur në dhomën tonë, për të parë punimet, dhe dilnin që andej të kënaqur, por, aty-këtu, edhe e lëshonin ndonjë fjalë për mua.

— Kur mësoi ky të presë dhe të qepë?!

—... E sidomos këtu në mes të vajzave...

— E pse, kur mësuam ne për abazhure e stufa metalike?! — ja priti një vajzë me flokë të verdha.



— Çudi se si rri i vetëm në mes të vajzave!...  
Unë, po të isha, nuk do të rrija asnjë minutë!  
— u hodh bullafiqi.

— Ju s'e njihni Petritin! Ai di vetëm të futet  
në punë e ta bëjë mirë atë. Ç'rëndësi ka se kush  
i qëndron pranë? — foli një shoku im.

— Shumë mirë e ka! Pse të mos rrijë me  
shoqet e të punojë me to? — foli përsëri vajza  
me flokë të verdha.

\* \* \*

Në gazetën «PIONIERI» lexova shkrimin për  
shpalljen e konkursit dhe takimin kombëtar të  
teknikëve, natyralistëve dhe gjeologëve të rinj.  
E lexova dhe, po atë ditë që kishim dhe rrethin,  
e solla gazetën në Shtëpinë e pionierit për t'ja  
treguar edhe instruktoret.

Mbasi e mbaruam së lexuari, të gjithë e pri-  
tëm me një «sa mirë!».

— Ne kemi mundësi të zëmë një vënd nderi  
në konkurs.

— Na duhet të punojmë edhe më tepër. Të  
kalojmë në prerje dhe në qepje më të vështira.  
Rrethi ynë është i ri dhe...

— T'ua kalojmë të gjitha rretheve teknike  
të Shtëpisë së pionierit!

— Në takimin kombëtar, në Tiranë, do të

kemi edhe ne përfaqësuesit tanë. Kë mendoni ju,  
vajza, të dërgojmë?

— Petritin! — thanë që të gjitha njëzëri.

— Jo, — u thashë, — pa ju unë nuk shkoj!

— Neve, vajza, na mbetet të hedhim shortin:  
Kujt t'i bjerë, do të fitojë të drejtën të shkojë  
me Petritin në takimin kombëtar...

Mirupafshim në Tiranë!...



## T È R K U Z A

**N**ë fshatin tonë u hap fjala anembanë se të rinjtë morën vendim të luftojnë kundër zakonit të ngarkesës me tërkuzë. Fjala u fut shtëpi më shtëpi e stan më stan dhe mori dhenë gjer në qytet.

\* \* \*

Ne organizuam menjëherë mbledhjen e kompanisë, pa asnjë të ftuar. Fjalën e mori komandanti ynë:

— Si thoni, do të ndihmojmë edhe ne pionierët që nënat dhe motrat tona të mos ngarkohen me tërkuzë?!

— Unë them se kemi mundësi!... Kjo na përket edhe neve pionierëve... Që nga Tirana erdhën dje në fshatin tonë për këtë të flamosur tërkuzë!... Unë shikoj nënën time: ngrihet menatë, merr

tërkuzën me vete, shkon punon në fushë një orë larg fshatit, gjersa perëndon dielli, pastaj ngarkohet me dru, dhe, kur vjen në shtëpi, sa nuk i bie të fikët. «Po ne shtëpinë e kemi plot me dru, moj nënë!», i them unë. «Le të ndodhen, biro, nuk na venë dëm!», më thotë. Nga të lodhurit, ka patur raste që ka fjetur edhe pa ngrënë.

Në klasë ra heshtja, por, që të mos zgjatej shumë, komandanti pyeti:

— Kush e do fjalën?

— Unë kam vetëm një pyetje: Si mund të luftojmë ne pionierët kundër tërkuzës?!

— Ne për këtë jemi mbledhur. Ja, si thua ti?

— E ku di unë? s'është aqë e lehtë të flasësh!..

— Nuk jam i një mendjeje me ty: Në rast se e kupton se tërkuzat duhet të flaket, duhet të mendosh edhe si!... Në radhë të parë ta fillojmë nga vajzat e kompanisë sonë: Të mos pranojnë të ngarkohen me tërkuzë si Zyrhaja, Zana, Fatimeja...

— Uuu, po nëna pastaj?!

— Mos thuaj «uuu»! Ti ke vëllanë komunist dhe me siguri që s'ka për të të lënë të ngarkohesh me tërkuzë, apo jo?

— Ashtu është!—u hodh nga fundi një tjetër.

— «Ashtu është», po nuk na the se me se do t'i marrin drutë, po të hiqet tërkuzat!

— Me kafshë, siç thanë dhe të rinjtë. Tamam, kafshët janë për t'u ngarkuar me dru!



Përse i mbajmë ato, apo për të ngrënë vetëm bar të thatë?!

Mbledhja mori zjarr.

— Unë s'ja prish dot nënës, sikur kështu të kthehet!...

— Ti, pa dashje, ashtu dëmton atë dhe veten tënde!

Rreth këtij mendimi u shprehën edhe të tjerë.

Vendimet tona ne i ngjitëm qysh atë ditë në gazetën e kompanisë.

\* \* \*

Kishte ditë që në fshat gratë dhe vajzat nuk ktheheshin më nga puna të ngarkuara me tërkuzë, por patrulla jonë e pionierëve kishte mësuar se ndonjë prej tyre kalonte fshehurazi nëpër rrapishte, që nga pas fshatit.


Ne të tre të patrullës zumë vend përmbi zallishte nga ku mund të shikoje të gjitha lëvizjet e njerëzve.

Në të perënduar të diellit, para nesh kaluan dy vajza. Dëgjuam këtë bisedë të shkëputur:

— ... Nuk të thashë, nëna ma dha prapë tërkuzën...

— Po ti pse e more?!...

— «Merre, moj bijë, sa për zakon, po mos u ngarko!», më tha ajo. Doja s'doja, e mora





dhe e futa në gji... Ja ku e kam, po mos e bëj fjalë!...

— Gabim e ke. Të mbash tërkuzën kot, sa për zakon!... S'të ka hije.

Ne e shënuam bisedën e tyre në bllokun e patrullës, për të sqaruar shoqen tonë që s'po vepronte mirë.

Në të ngrysur, u ngritëm për të marrë rrugën e fshatit, kur, ç'të shikonim: Zana na qe ngarkuar me tërkuzë!

— Pse kështu moj Zanë? — iu drejtuam ne.

— Uuu, e zezat! — u tremb ajo dhe lëshoi stivën e druve për tokë.

— Mos ki frikë. Ne jemi shokët e tu! Kemi ardhur të të ndihmojmë! Po qe se ke mbetur pa dru, i mbajmë bashkë. Të ndihmojmë dhe nesër.

Ajo u hutua dhe nuk dinte nga të kapte fjalën tonë:

—... E di,...jo... nuk kemi mbetur pa dru... Nëna nuk do që unë të prish zakonin. Dru sollti babaj me kafshë dhe prapë do të sjellë.. Nëna nuk dëgjon kollaj...

Ne iu afruam dhe filluam të zgjidhnim drutë e lidhura me tërkuzë.

— Mos m'i shpërndani! Unë mezi i mblodha! — na porositi Zana.

— Këto ne do t'i çojmë bashkë në shtëpi. Po ti na jep fjalën se nuk do të ngarkohesh më me tërkuzë.

— Ta djegim tërkuzën — sekush tha nga djemtë.

— Jo, është më mirë ta djegë vetë Zana! — ja kthyem ne të tjerët. — Sipas vendimit të kompanisë, kemi për detyrë vetëm të mos e lemë të ngarkohet. Na, merre, Zanë! — dhe i hodhi tërkuzën mbi sup.

Zana uli kokën e turpëruar dhe, ndërsa ne filluam të ndanim stivën e druve në tri pjesë, ajo mblodhi tërkuzën lësh dhe e hodhi në një hendek me ujë të ndënjur.

Pastaj ajo përpara dhe ne pas, me drutë në duar, u drejtuam për në fshat te shtëpia e Zanës.



## GURËGDHËNDËSI I VOGËL

— **M**ë falni,... unë nuk kam dëshirë të qëndroj më në këtë rreth!... Ka mundësi ta ndërroj?! — i thashë drejtorit të Shtëpisë së pionierit.

Ai u mundua të më bindte se rrethi i gurëgdhëndësve është nga më të mirët, por, kur pa se nuk ia doli dot, më tha:

— Mirë, shko në rrethin që dëshiron!

\* \* \*

— Eja me mua në rrethin e akrobatëve! — më tha një shoku im. U mendova ca:

— Po mirë, me se merreni ju në atë rreth?

— Me ushtrime akrobatike. Në mbrëmjen qëndrore të Vitit të ri do të japim një numër të veçantë.

— Mirë, me që qenka kështu, do të vij edhe

unë, por, më parë, duhet t'i marr leje drejtorit.  
— I them unë instruktorit; njëlloj është.

\* \* \*

Në rrethin e akrobatëve qëndrova vetëm dy javë. Jo se nuk më tërhoqi, po ato të shkreta ushtrime donin guxim të madh. Mua më bëhej gjaku ujë.

Ç'më ndodhi një herë: Instruktori më caktoi me dy të tjerë të formonim piramidën. Unë duhej të vendosja këmbët mbi kokën e tij, që mbahej në një qafë të fortë e të trashë si trung. T'i thoshja se s'mundesha, më vinte turp. Zëmra filloi të më hidhej si e zogut.

— Mos u dridh, mos u frikëso! — më thaj ai, kur këmbët e mia u mbështetën mbi gjoksin e tij.

— Jo, jo, — i thashë unë krenar — dridhem, se kam pak si ftohët!...

Më në fund hipa. Kur qafa e tij lëvizte ndonjëherë, në trup më shkonin të dridhura. Unë e dija, po ç'të bëja!... «S'qënka gjë kjo punë, o Mete! — i thashë vetes, — do të biesh këndeje e do t'i bësh turinjtë përshesh, po ik me kohë të mirë!...»

Kur instruktori ngriti përpyetë dy të tjerët, unë e humba «ekuilibrin», siç thonë akrobatët,



e, po të mos më priste ndihmësi i tij, Metja sot e kësaj dite, o vëllezër, do të qe në spital. E dëgjova dimrin shpejt, siç thotë një fjalë e urtë, dhe nuk u duka më në atë rreth.

\* \* \*

Unë kisha ndërruar gjer atëhere katër rrethe. Një ditë u ndodha përballë drejtorit të Shtëpisë së pionierit. Sa e pashë, iu shmanga takimit. S'kisha si veproja ndryshe. Ç't'i thoshja, po të më pyeste për punën në rreth?!

I shikoja shokët, që hynin e dilnin nëpër dhoma, të gëzuar dhe të qeshur, të bisedonin për punën e tyre, kurse mua ende më mundonte pyetja «Në ç'rreth të marr pjesë?!»

Një ditë u betova, duke i thënë vetes: «Në rast se largohe edhe një herë nga rrethi, o Mete, je burracak e frikacak!».

Vendosa të bisedoja edhe me babin, të më jepte edhe ai ndonjë mendim. Ja lexova me radhë të gjitha rrethet, të shtypura në një fletushkë në shtypshkronjën e Shtëpisë së pionierit.

— Këtu qëndro! — më tha babi — Në këtë rreth të shkosh edhe ti! Puna e gurgdhëndësve është art dhe nderohet nga të gjithë në vendin tonë. Ne projektojmë godina, por bukurinë e vërtetë ua jep guri. Ti, sigurisht, e ke parë hotel Turizmin, Pallatin e kulturës... Sa të bukur kanë

dalë!... Unë jam inxhenjer, dhe gurgdhëndësve u heq kapelen. I madh e i vogël i nderon ata.

— Po Shefkui më tha se ata mësojnë për muratorë, mor babi.

— Në rast se punon mirë dhe me nder, një-lloj është në të gjitha detyrat. Shefkui do të pendohet më vonë për këtë përçmim të punës së muratorit... Shpjegoja ti që ta kuptojë drejt!...

\* \* \*

Babi erdhi vetë atë ditë në Shtëpinë e pionierit. I ra derës; doli instruktori i rrethit. Sa turp që më erdhi!

Ndërsa babi filloi të bisedonte me të, fëmijët, sa më panë filluan të më ngacmonin me zë të ulët:

— Uuu, kush na erdhi!

— Turisti i Shtëpisë së pionierit!

— Akrobati!

— Violinisti!

— Zdrukthëtari!

— ... Dhe prapë gurgdhëndës!

— Po! — u thashë unë në mënyrë të prerë dhe serioz, duke i ndërprerë romuzet e tyre.

Në këto e sipër, në dhomë u fut babi me instruktorin. Pionierët vazhduan punën, duke gdhëndur gurin me dalta dhe çekanë.



Mua më mbetën sytë tek punimi i njerit prej tyre, i atij që më tha «dhe prapë gurgdhëndës». Edhe babi shprehu habinë:

— Vetë e ke gdhëndur ti këtë gur?!

— Po!

— Pa ndihmën e instruktorit?!

— Pa ndihmën time! — e siguroi instruktori. «Sa bukur!», thashë unë me vete.

— Sa bukur! — tha dhe babi — Ky gur nuk ka ndryshim me atë të mjeshtëreve tanë!... Edhe ju të tjerët shumë mirë kini punuar! Ju lumtë, djema! Në këtë rreth do të vijë edhe djali im, apo jo?

— Po! — i thashë unë, si i zënë në faj.

— Do ta pranoni? — pyeti babi me shaka.

— Po! — thanë të gjithë.

\* \* \*

Në një mbledhje, që organizoi Këshilli Popullor i lagjes, mora dhe unë pjesë.

Kryetari i Këshillit, midis të tjerave tha: «...Ne duhet të ndërtojmë në thellësi kalldrëme, që ta zbukurojmë e ta mbajmë më pastër lagjen, që dhe të moshuarit të kalojnë me lehtësi... Po kemi një pengesë përpara: kemi pak gurgdhëndës.

— T'u kërkojmë ndihmë lagjeve të tjera! — u dëgjua një zë.

— Ata i duan për kalldrëmet e tyre!

— Di Hasani!

— Jo, unë di vetëm të gatuj llaç!

— Di Mufiti!

— Nuk ja shkrep edhe unë! Me kazëm, po, jam gati të punoj! E mori fjalën babi:

— Më falni, shokë! — tha ai — Unë do t'ju jap një gurgdhëndës shumë të mirë, — të gjithë rrinin në pritje, — djalin tim. Mos u çuditni! Ky ka mësuar në Shtëpinë e pionierit kaqë mirë... le të marrë me vete dhe shokët e tij.

— Po, — ja preu fjalën një tjetër, — kam dëgjuar edhe unë për ta.

— Atëhere, ne e kemi të zgjidhur problemin: Me këto forca mund t'ja dalim mbanë...

T'ju them të drejtën, qysh në ato çaste, përpara banorëve të lagjes sonë, unë ndjeva gëzimin dhe krenarinë e punës, kënaqësinë e parë të gurgdhëndësit.

Unë u dhashë fjalën atyre se do të merrja me vete të gjithë pionierët e lagjes për ta bërë ndërtimin e kalldrëmeve aksionin tonë.



## PËRMBAJTJA E LËNDËS

	Faqe
Si ja morën radion prefektit . . . . .	3
Tek ura e vjetër . . . . .	9
Camunxat . . . . .	15
Teatri «Çarçafi» . . . . .	20
Rreth zjarrit partizan . . . . .	28
«Ju lutem, sa e kini orën?» . . . . .	32
Kujtesa . . . . .	35
Dhurata . . . . .	40
I vetëm në rrethin e rrobaqepsisë . . . . .	44
Tërkuza . . . . .	50
Gurgdhendësi i vogël . . . . .	56